

1. OE “Sinteza CO” sh.p.k., me NIPT K11324003F, për arsye se:

- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.2, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi autorizimi i distributorit të autorizuar të paraqitur në SPE, nuk vërteton se ka mbështetje apo është i autorizuar nga prodhuesi i produktit të ofertuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE “EMC Group” sh.p.k., me NIPT L71819032P**, Adresa: Tiranë, Njesia Bashkiake Nr. 6, Rruga “Vasil Tromara”, Pallati Nr. 20, Kati 1, Zyra 3 & **“IT Store” sh.p.k. me NIPT L72121021O**, Adresa: Tiranë, Rruga “Hysni Gerbolli”, Ndërtesa 33, hyrja 4, 1026, se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **18,911,000 (tetëmbëdhjetë milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me adresë Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë - Durrës, Km. 9, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10 (dhjetë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar dhe tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO ☐ JO ☒

ADMINISTRATOR I OST SH.A.

Skerdi Drenova